

LIGJ
Nr. 7/2019

PËR RATIFIKIMIN E PROTOKOLLIT TË TRAKTATIT TË ATLANTIKUT VERIOR
PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në mbështetje të neneve 78, 83, pikat 1 e 2, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet Protokollin e Traktatit të Atlantikut Verior për aderimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.2.2019

Shpallur me dekretin nr. 11083, datë 20.2.2019 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

PROTOKOLL
I TRAKTATIT TË ATLANTIKUT VERIOR PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË
MAQEDONISË SË VERIUT

Palët e Traktatit të Atlantikut Verior kanë nënshkruar në Uashington, më 4 prill 1949, duke qenë të bindura se siguria e zonës së Atlantikut Verior do të rritet me aderimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në këtë Traktat, bien dakord si më poshtë vijon:

Neni I

Me hyrjen në fuqi të këtij Protokoll, Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior i njofton Qeverisë së Maqedonisë së Veriut, në emër të të gjitha Palëve, ftesën për t'u pranuar në Traktatin e Atlantikut Verior. Në përputhje me nenin 10 të Traktatit, Republika e Maqedonisë së Veriut bëhet Palë në datën kur depoziton instrumentin e saj të aderimit te Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Neni II

Ky Protokoll hyn në fuqi kur secila nga Palët e Traktatit të Atlantikut Verior ka njoftuar Qeverinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për pranimin e saj. Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës informon Palët e Traktatit të Atlantikut Verior mbi datën e marrjes së këtij njoftimi, si dhe datën e hyrjes në fuqi të këtij Protokoll.

Neni III

Ky Protokoll ku tekstet në gjuhën angleze dhe frënge janë njëllëj autentike, depozitohet në

Arkivat e Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kopjet e njësuara me Protokollin dërgohen nga Qeveria e SHBA-ve te qeveritë e të gjitha Palëve të Traktatit të Atlantikut Verior.

Në dëshmi të sa më sipër, nënshkruesit e pajisur me plotfuqi kanë nënshkruar këtë Protokoll. Nënshkruar në Bruksel, më 6 shkurt 2019.

Për Republikën e Shqipërisë

Për Mbretërinë e Belgjikës

Për Republikën e Bullgarisë

Për Kanadanë

Për Republikën e Kroacisë

Për Republikën Çeke

Për Mbretërinë e Danimarkës

Për Republikën e Estonisë

Për Republikën e Francës

Për Republikën Federale të Gjermanisë

Për Republikën e Greqisë

Për Hungarinë

Për Republikën e Islandës

Për Republikën e Italisë

Për Republikën e Letonisë

Për Republikën e Lituanisë

Për Dukatin e Madh të Luksemburgut

Për Malin e Zi

Për Mbretërinë e Holandës

Për Mbretërinë e Norvegjisë

Për Republikën e Polonisë

Për Republikën e Portugalisë

Për Rumaninë

Për Republikën e Sllovakisë

Për Republikën e Sllovenisë

Për Mbretërinë e Spanjës

Për Republikën e Turqisë

Për Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut

Për Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Vula e Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut, datë 6.2.2019, është për të vërtetuar se ky dokument (i përbërë nga 9 fletë) është kopje e njëjtë me origjinalin.

Bruksel, 6 shkurt 2019